



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA E KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE/NATIONAL AUDIT OFFICE

Në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, dispozitave të Rregullores Nr. 02/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L – 149, nenit 4 dhe 15 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit ri-shpall:

KONKURS
për plotësimin e vendit të punës

Pozita: Udhëheqës i Njesisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte
Referenca: BNP/ZKA/19-08/17
Koeficienti: 9 (nëntë)
Numri i pozitave: 1 (një)
Përgjegjësitë mbikëqyrëse: Jo
I përgjigjet: Auditorit të Përgjithshëm
Vendi: Prishtinë

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës:

Udhëheqësi i Njesisë për Projekte dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, menaxhon dhe koordinon aktivitetet bashkëpunuese ndërkombëtare të ZKA-së me ISA-të, dhe institucioneve të tjera, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe ngritjes së kapaciteteve të ZKA-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të ZKA-së, në shkëmbimin e informacionit dhe përvojave me Institucionet Supreme të Auditimit, për të maksimizuar dobitë dhe lehtësuar zhvillimin e qëndrueshëm të auditimit publik;
2. Përgjegjës për zhvillimin dhe planifikimin e propozime për bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve tjera si dhe vlerëson propozimet e pranuar nga jashtë;
3. Siguron përpunimin, koordinimin dhe përgatitjen e dokumentacionit për pjesëmarrje në projekte të bashkëpunimit dhe siguron zbatimin e tyre;
4. Përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe bashkëpunuese;
5. Koordinon dhe ofron mbështetje për pjesëmarrjen e punonjësve të ZKA-së në grupe ndërkombëtare të punës dhe projekte të përbashkëta të auditimit;
6. Kryen funksionin ndërlidhës në aktivitetet me organizatat profesionale të auditimit dhe Institucionet Supreme të Auditimit;

7. Përgatit raporte periodike mbi aktivitetet e njësive që kërkojnë shqyrtim nga mbikëqyrësi;
8. Kryen detyra tjera sipas kërkesave nga mbikëqyrësi.

Kualifikimet minimale, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë fakulteti, në fushën e ekonomisë, drejtësisë apo administratës publike;
- Përvojë pune profesionale së paku prej gjashtë (6) vitesh, prej tyre tri (3) vite përvojë menaxheriale;
- Të posedoj aftësi të mira komunikimi dhe në të shkruar për gjuhët zyrtare dhe gjuhës angleze;
- Aftësi hulumtuese në projekte relevante për veprimtarinë e ZKA-së;
- Aftësi në hartimin, prezantimin dhe koordinimin e projekteve;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale;
- Shkathtësi të mira organizative;
- Shkathtësi të mira në komunikim.

Procedura e Konkurrimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse. Zyra Kombëtare e Auditimit mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, te të gjitha komuniteteve.

Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe mund të shkarkohet nga faqja e internetit e Zyrës Kombëtare të Auditimit: <http://www.zka-rks.org/>

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet e-mailit në adresën: rekrutimi@oagks.org, nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në kopje fizike në Zyrën Kombëtare të Auditimit, në rrugën “Musine Kokalari” nr. 87, prej orës 08:00 – 16:00. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025 dhe 038/606-004, ext:1011.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në faqen e internetit të ZKA-së dhe në shtypin ditor me datën 19 gusht 2017.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit, nuk do të pranohen. Të gjitha kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë

brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë konkurs do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Divizioni për Burime Njerëzore.